



REPUBLIKA E KOSOVES AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-0/DPK</u> Nr. llogar. Broj stranica Nr. pages <u>02</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-4952/15</u> Prot. No. Data Datum <u>30.12.2015</u> Date



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-4175/15, për z. Qazim Qeska – Anëtar i Bordit në Kompaninë Rajonale të Ujësjetllësit “Radoniqi” Sh.a., për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për z. Qazim Qeska – Anëtar i Bordit në Kompaninë Rajonale të Ujësjetllësit “Radoniqi” Sh.a., është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë z. Qeska është hetuar për konflikt interesi për shkak se krahas funksionit publik të anëtarit të bordit, ka ushtruar edhe veprimtarinë private të avokatisë.

Agjencia kundër Korrupsionit fillimisht zyrtarit i ka dërguar shkresën njoftuese për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës ai është takuar me zyrtarët e Agjencisë.

Në takim z. Qeska është njoftuar se nuk mund të ushtroj njëkohësisht funksionin e anëtarit të bordit dhe atë të avokatit. Ai ka deklaruar se do të jap dorëheqje nga funksioni i anëtarit të bordit në Kompaninë “Radoniqi”, në mënyrë që të vazhdoj ushtrimin e detyrës së avokatit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të deponuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, me të cilën dëshmohet se z. Qeska ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të bordit të Drejtorëve në KRU “Radoniqi”. Me këtë ai ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

